



Lidhje  
për njohuri

Lidhje  
për biznes

Lidhje  
për kapital

Lidhje  
për rritje

**Ndërmarrës,  
Mirë se vini në CEED Club!**

## Lidhu për rritje, zhvillim dhe kapital!

CEED Club përkrah mbi 3000 ndërmarrës globalisht dhe mbi 400 ndërmarrës aktiv në Kosovë. Ne i lidhim ndërmarrësit dhe ndihmojmë të zhvillojnë kompanitë e tyre. Lidhjet i bëjmë në tri nivele: lidhje për njohuri (shkëmbim i përvojave të ndërmarrësve), lidhje për kontakte të biznesit (brenda dhe jashtë vendit), dhe lidhje për kapital (qasje në kapital dhe përgatitje për financim). Gjithashtu rrisim nivelin e njohurive ndërmarrëse dhe promovojmë ndërmarrësinë si një vlerë pozitive në shoqëri, e cila krijon komunitetin inovativ dhe të hapur.

**400**

NDËRMARRËS AKTIV NË RRJETIN E  
CEED KOSOVA



**3.000**

NDËRMARRËS NË RRJETIN E  
CEED GLOBAL



**22**

SHTETE



SHQIPËRI | ARMENI | BANGLADESH | BOSNJË DHE HERCEGOVINA | BULLGARI | KOSOVË  
MAQEDONI | MALI I ZI | MAROK | RUMANI | SERBI | SLLOVENI | TUNIZI | SHBA

Bashkohu me ne.

**CEED Club** ka tre nivele të anëtarësimit: **GROW, PRO** dhe **EXCLUSIVE**



**Shtyje përpara shitjen dhe pozitën në treg, si dhe gjej rrugën drejt rritjes!**

Grow Club është për ndërmarrësit në zhvillim, të cilët kërkojnë të rrisin vëllimin e shitjeve, të zgjerojnë rrjetin e tyre të biznesit dhe të përmirësojnë pozitën e tyre në treg. Programi gjithashtu trajton çështjen se si të mbledhë një ekip të fortë, të ruaj rritjen financiare dhe të përballet me sukses në sfidat e tregut.

#### CLUBI OFRON:

- **Mësime të bazuara në përvojë:** 9 takime mujore me ndërmarrës të suksesshëm të cilët ndajnë eksperiencën e tyre shumëvjeqare, sfidat dhe mundësitë me të cilat edhe vetë janë përballur
- Takime individuale me **mentorë** për ti zgjidhur sfidat e biznesit
- **Rrjetformim** për tu lidhur me një komunitet të ndërmarrësve lokal dhe ndërkombëtar në Konferenca të Biznesit, B2B, Ngjarje Shoqërore dhe Dreka Biznesi
- **Qasje në financa**, lidhje me investitorë potencial dhe institucione financiare
- **Programme të specializura për menaxhim** të dizajnuara për ekipin tuaj: CEED Finance, Marketing & Sales, Process & Operations, Social Media, Burime Njerëzore
- **Shërbime individuale** për të zgjidhur sfidat e biznesit tuaj



**Si të fitojmë fokus dhe efikasitetin në biznes me ekipin tuaj profesional të udhëheqjes?**

Pro Club është për ndërmarrës dhe menaxherë të cilët janë në poste udhëheqëse. Ky program ka fokus të veçantë në avancimin e aftësive të buta (soft skills) të cilat janë të domosdoshme për secilin menaxher apo ndërmarrës, që udhëheqin kompani si dhe kërkojnë të arrijnë sukses dhe rritje të shpejtë.

#### CLUBI OFRON:

- **Mësime nga konsulentë/ekspertë me përvojë:** 7 punëtori një ditore për zhvillimin e aftësive udhëheqëse, avancimin e aftësive negociuese, ndërtimin e një ekipi efikas, si dhe udhëheqjen dhe motivim e punonjësve
- Takime individuale me **konsulentë** për ti zgjidhur sfidat e biznesit
- **Rrjetformim** për tu lidhur me një komunitet të ndërmarrësve lokal dhe ndërkombëtar në Konferenca të Biznesit, B2B, Ngjarje Shoqërore dhe Dreka Biznesi
- **Programme të specializura për menaxhim** të dizajnuara për ekipin tuaj: CEED Finance, Marketing & Sales, Process & Operations, Social Media, Burime Njerëzore
- **Shërbime individuale** për të zgjidhur sfidat e biznesit si dhe për të diagnostifikuar dhe planifikuar strategjinë tuaj



**Qëndro aktiv në treg, zhvillo ekipin tuaj dhe bëhu pjesë e rrjetit ndërkombëtar të CEED!**

Exclusive Club është për ndërmarrës, themelues dhe pronar të biznesit, të cilët janë të fokusuar në krijimin e një rrjeti të zgjedhur të partnerëve lokal dhe ndërkombëtar, rritjen e biznesit në një nivel tjetër, avancimin dhe zhvillimin e punonjësve më me perspektivë në kompanitë e tyre.

#### CLUBI OFRON:

- **Rrjetformim** me një komunitet të zgjedhur të ndërmarrësve lokal dhe ndërkombëtar në ngjarje ekskluzive të biznesit, Konferenca të Biznesit, B2B, Ngjarje Shoqërore dhe Dreka VIP Biznesi
- **Mundësi anëtarësi në Global Club**, duke ju mundësuar udhëtime biznesi, Webinar: pyetni ekspertin, si dhe takime me udhëheqës të bizneseve ndërkombëtare
- **Pjesë e mentorëve** në CEED klubin e mentorëve
- **Programme të specializura të menaxhimit për ekipin tuaj:** CEED Pro, Finance, Marketing & Sales, Process & Operations, Social Media, Burime Njerëzore
- **Shërbime individuale** për të zgjidhur sfidat e biznesit si dhe për të diagnostifikuar dhe planifikuar strategjinë tuaj
- **Shërbimet tjera:** vizita në kompani, mbështetje në rekrutim të punonjësve, publikimi i logos dhe profilit në portal të CEED-it

## 7 arsye për t'u bashkuar në CEED Club

CEED përkrah ndërmarrësit e etur për të marrë hapin e ardhshëm në ndërtimin e një kompanie të suksesshme, si dhe të krijojnë lidhje të reja të biznesit brenda dhe jashtë vendit.

#### Brenda rrjetit të CEED ju do të:

- 1 Zgjeroni rrjetin tuaj të biznesit brenda dhe jashtë vendit.
- 2 Zbuloni mundësi të reja biznesi.
- 3 Fitoni njohuri të reja dhe mësoni nga përvoja e të tjerëve.
- 4 Gjeni njerëz të cilët mund të ju ndihmojnë të zgjidhni sfidat e biznesit tuaj.
- 5 Zgjeroni horizontin tuaj dhe zhvilloni ide të reja inovative.
- 6 Fitoni guximin dhe energjinë për të bërë lëvizjen tuaj të ardhshëm strategjik.
- 7 Merrni qasje në 22 tregjet ndërkombëtare.